

PLANI I KYÇJES PËR PALËT E PËRFSHIRA

PËR PROJEKTIN E TRANSPORTIT URBAN TË PRISHTINËS

1. PËRSHKRIMI DHE KONTEKSTI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("BERZH" apo Banka) është duke shqyrtuar një hua deri në 10 milion Euro ndaj kompanisë për transport publik të Prishtinës të quajtur Trafiku Urban (TU), për të financuar modernizimin e flotës së autobusëve të saj përmes blerjes së deri në 51 autobusëve të rinj me dysheme të ultë dhe përmes modernizimit të depos së mirëmbajtjes. Autobusët e rinj do të ofrojnë ambient më të rehatshëm për udhëtarët, janë më efikas, prodhojnë më pak ndotje dhe ofrojnë qasje më të lehtë për personat me aftësi të kufizuara. Projekti nuk do të përfshijë ndonjë ndryshim ndaj linjave ekzistuese të udhëtimit.

TU është një qind për qind në pronësi të Komunës së Prishtinës ("Prishtina" apo "Qyteti"), që ofron shërbimet e saj në hapësirën urbane dhe ndër-urbane të Qytetit.

Gjendja e tanishme e sistemit transportues publik është mjaftë e dobët. Kompania për momentin operon me dhjetë autobusë, ku të gjithë janë në gjendje të dobët dhe të pariparueshme. Koha e përdorimit të tyre deri më tani mesatarisht kalon 10 vite. Një gjendje e tillë e flotës nuk është e pranueshme për ambientin, posaçërisht në lidhje me ndotjen, zhurmën dhe mungesën e besueshmërisë. Si shtesë ndaj kësaj, flota ekzistues nuk përmbushë kërkesat bazike të sigurisë ku dritaret e thyera, dyert e lakuara apo pjesët në mungesë të sigurisë janë gjë e zakonshme.

Nën dritën e kësaj që u tha një nga detyrat kyçe të administratës së re të Qytetit të Prishtinës është zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të transportit publik në Qytet. Kjo do të bëhet duke themeluar një kornizë të re të punës për operacionet e sistemit të transportit publik, dhe qëllimi është të përdoret Kompania si një agjent i ndryshimit. Si hap i parë, 51 autobusët do të merren me qëllim të sigurimit të shërbimeve adekuate publike në linjat kyçe të transportit të qytetit. Në të njëjtën kohë Kompania do të përmirësoj substancialisht performancën e saj operative dhe financiare dhe do të zhvillohet në një shërbim të qëndrueshëm i cili operon nën mbikëqyrjen e komunës në përputhje me Kontratën e Shërbimeve Publike transparente.

2. QËLLIMI DHE PËRGJEGJËSIA PËR IMPLEMENTIM TË PLANIT PËR PALËT E PËRFSHIRA

Qëllimet e Planit për Palët e Përfshira janë që të:

- Identifikohen komunitetet të cilat janë apo mund të ndikohen nga projekti si edhe palët tjera të interesuara;
- Të sigurohet se këto palë janë të informuara në mënyrë adekuate dhe të konsultuara mbi çështjet të cilat mundën që të ndikojnë në ato potencialisht; dhe
- Zhvillohet një marrëdhënie konstruktive me palët e përfshira në baza të vazhdueshme gjatë përgatitjes dhe operimeve pasuese.

Implementimi i këtij Planit është përgjegjësi e TU-së dhe Komunës.

3. PALËT E PËRFSHIRA TË IDENTIFIKUARA DHE METODAT E KOMUNIKIMIT

Palët e përfshira të identifikuar gjatë shqyrtimit janë prezantuar me sa vijon, së bashku me mjetet për komunikim në dispozicion për çdo grup të palëve të përfshira.

Tabela 1: Mjetet për palët e interesuara dhe për komunikim

Grupi i identifikuar i palëve të përfshira	Pika kontaktuese	Çështjet relevante	Mjetet e propozuara për komunikim
Komuna e Prishtinës	Bordi i drejtorëve	Menaxhmenti i	Mbledhjet e rregullta dhe Ad hoc

(pronari)	z. Ruhan Beha Drejtor i Bordit të Drejtorëve +377 44 555 266 ruhan.beha@trafikurban-pr.com	kompanisë Shërbimet Ankesat	Raportimi ndaj komunës (raportet tremujore dhe vjetore)
Konsumatorët	Linjat telefonike të TU-së Kabinat e TU-së Kabinat janë të vendosura brenda ndërtesës së TU-së dhe ne ndërtesën e Komunës Formulari për ankesa	Kërkesa për informim Ankesat	Webi i TU-së dhe Komunës (https://kk.rks-gov.net) (https://kk.rks-gov.net)
Popullata e përgjithshme e Prishtinës dhe rrethinës		Kërkesa për informim Ankesat	Linjat telefonik të TU-së +38345101122 (ky numër është në dispozicion prapa tiketave) Fleta për Informin e Projektit
Shtëpitë dhe bizneset në rrethinë të linjave të autobusëve dhe të stacioneve		Kërkesa për informim Ankesat Konsultimet	Fleta për Informin e Projektit Broshurat gjenden në autobusët e rinjë dhe në stacione
Grupet e kufizuara: të varfërit, të personat me aftësi të kufizuara, gratë, minoritetet	Linja telefonike të TU-së Kabinat e TU-së Formulari për ankesa	Kërkesa për informim Ankesat	Webi i TU-së dhe Komunës (https://kk.rks-gov.net) Linjat telefonik të TU-së Fleta për informim mbi projektin Dëgjimet informative dhe mbledhjet konsultuese sipas kërkesës Informatat do të jepen në gjuhë Turke, Boshnjake, dhe Rome nëse ato kërkohen
Ofruesit e shërbimeve publike (shkollat, spitalet, etj.)	Trafiku Urban JSC Rruga Tahir Zajmi bb Prishtinë, Kosovë Personi kontaktues: z. Lulzim Rexhepaj +377 44 135 716 lulzim.rexhepaj@trafikurban-pr.com	Konsultimet Ankesat	Fleta për informim mbi projektin Mbledhjet konsultuese
Operuesit e autobusëve privat (përfshirë kontraktuesit) dhe shoqata e tyre	NJëjtë si më lartë. Formulari për ankim.	Ndarja e informatave Konsultimet	Fleta për informim mbi projektin Web-i i TU-së apo i Komunës (https://kk.rks-gov.net) Mbledhjet konsultuese
Ofruesit tjerë të transportit publik		Ndarja e informatave	Fleta për informim mbi projektin Web-i i TU-së apo i Komunës (https://kk.rks-gov.net)
Kompanitë që marrin me qira hapësirat në bazën e Kompanisë		Kërkesa për informim Ankesat Konsultimet	Fleta për informim mbi projektin Mbledhjet konsultuese

4. DHËNIA E INFORMATAVE

TU do të jep të gjitha informatat relevante rreth projektit ndaj publikut përmes websajtit të saj dhe atij të Komunës. Në minimum, dokumentet në vijim do të bëhen publike:

- Përmbledhje e projektit/Fleta për informim
- Plani për ambient dhe plani Social
- Plani për kyçje të palëve të përfshira
- Formulari për ankesa
- Raportet e monitorimeve

Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet nevojave të grupeve të rrezikuara, dhe masa të posaçme do të ndërmerren, siç janë postimi i kopjeve të shtypura të dokumenteve në kërkesë, apo ofrimin e kopjeve të shtypura në hapësirat e Komunës sipas nevojave. Si shtesë ndaj kësaj, kopje të dokumenteve do të shpërndahen ndaj komuniteteve lokale brenda Komunës së Prishtinës.

Të gjitha informatat do të jenë në dispozicion në gjuhën angleze dhe në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë (gjuha shqipe dhe serbe). Sipas kushtetutës së 2008, gjuhët boshnjake, turke, dhe rome gjithashtu kanë status zyrtar në komuna relevante. Informatat do të vihen në dispozicion në këto gjuhë sipas kërkesës, nëse është e përshtatshme.

5. KYPJA E PALËVE TË PËRFSHIRA

Palët e përfshira do të informohen rreth fushëveprimit të Projektit dhe informatave kontaktuese paraprakisht fillimit të projektit dhe në linjë me orari në e poshtëshënuar. Ata do të informohen rreth dokumenteve të projektit në dispozicion dhe mekanizmave për ankesa në TU dhe në ueb-in e Komunës si edhe për mundësinë e pranimit të versionit të shtypur ndaj grupeve të rrezikuara sipas kërkesës. Informatat e këtij lloji do të ndahen përmes informatave të projektit para implementimit të projektit. Si shtesë ndaj kësaj, me këtë qasje ndaj palëve të përfshira do të përfitojnë nga informatat e mbledhura dhe nga mësimet përmes Projektit për Lëvizshmëri Urbane, të cilën Komuna ka për qëllim ta implementoj me përkrahje të BERZH-it në të njëjtën kohë me këtë projekt.

Tabela 2. Orari për Aktivitetet e Kyçjes së Palëve të Përfshira

Aktiviteti	Datat e pritura	Përgjegjësia
Shpërndarja e informatave të projektit ndaj publikut (Një faqe A4 e Informimit apo një broshurë)	Paraprakisht ndaj implementimit të projektit <i>Afati i ndikativ: Nëntor 2018</i>	Kompania me përkrahjen e Komunës
Informatat mbi projektin /dokumentet e vëna në dispozicion ndaj publikut në: ueb-in e TU-së dhe të Komunës	Paraprakisht ndaj implementimit të projektit <i>Afati i fundit: Nëntor 2018</i>	Kompania dhe Komuna
Vendosja e faqes për informim në ueb-in e Komunës dhe të tabelave të buletineve të LNC-ve	Paraprakisht fillimit të Projektit <i>Afati i fundit: Nëntor 2018</i>	Komuna me përkrahjen e Kompanisë
Mbledhjet me palët e interesuara	Sipas nevojës	Komuna, Kompania dhe Kontraktuesit
Pjesëmarrja në mbledhje të Planifikimit të Lëvizshmërisë Urbane (UMP) aktivitetet për kyçjen e palëve të interesuara	Në linjë me orarin e kyçjes së palëve të përfshira *	Kompania

*Të përcaktohet nga UMP e projektit.

6. MEKANIZMI I ANKESAVE

Komentet apo brengat mund të vihen në vëmendje të TU-së apo të Komunës verbalist apo në të shkruar (përmes postës apo emailit) apo përmes plotësimit në formularin e ankesave (të bashkëngjitur në fund të dokumentit). Personi i brengosur do të tregoj në komunikimin e tij/saj nëse ai/ajo dëshiron që emri i tij/saj të mbetet konfidencial.

Të gjitha ankesat (të shkruara apo verbale) do të vendosen në një regjistër dhe do të shënohen me nga një numër, dhe di të shqyrtohen brenda 7 ditëve.

TU dhe Komuna do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të adresuar ankesat mbi pranimin e ankesave. Nëse ata nuk janë në gjendje të adresojnë çështjet e ngritura përmes veprimeve të menjëhershme përmirësuese, një veprim afat-gjatë përmirësues do të identifikohet. I ankuari do të informohet mbi veprimin përmirësues

dhe mbi vazhdimin e tij brenda 25 ditëve nga pranimi i ankesës (shih procesin e ankesave në fund të këtij dokumenti).

Nëse Komuna dhe TU nuk janë në gjendje të adresojnë çështjen e ngritur përmes mekanizmit të ankesave apo nëse një veprim nuk është kërkuar nga këto, ata do të ofrojnë një shpjegim të detajuar/arsyetim për arsyen pse çështja nuk është adresuar. Përgjigja gjithashtu do të përmbajë shpjegimin se si personi/organizata e cila ka ngritur çështjen mund të vazhdojë me ankesa në rast se rezultati nuk është i kënaqshëm. Një mekanizëm i ndarë i ankesave është në dispozicion për punëtorët.

Të gjithë kontraktuesit duhet të përcjellin këtë mekanizëm të ankesave për të adresuar ankesat. TU dhe Komuna do të monitorojnë aplikimin e mekanizmit të ankesave nga kontraktuesit.

7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Rezultatet e procesit të kyçjes së palëve të përfshira do të përfshihen në raportet e monitorimit të projekteve, duke përfshirë: çështjet dhe brengat e ngritura gjatë procesit konsultues; dhe numri dhe llojeve të ankesave të ngritura në periudhën raportuese dhe të numrit të ankesave të zgjidhura dhe/ose të jashtëzakonshme. Raportet gjithashtu do të përfshijnë një përmbledhje të masave të implementuara të masave përmirësuese me qëllim të adresimit të ankesave. Raportet e monitorimit do të bëhen publike në ueb-in e TU-së dhe të Kompanisë.

8. INFOMATAT KONTAKTUESE

Trafiku Urban Sha.

Rruga Tahir Zajmi bb

Prishtinë, Kosovë

Personai për kontakt:


z. Lulzim Rexhepaj

+377 44 135 716

Email: lulzim.rexhepaj@trafikurban-pr.com



9. PAMJA E RRJEDHËS SË PROCESIMIT TË ANKESAVE



10. FORMULARI PËR ANKESË PUBLIKE

Numri i referencës:	
Emri i plotë	
Informatat kontaktuese	<input type="checkbox"/> Përmes postës (ju lutemi jepni adresën e postare): _____ _____ _____
Ju lutemi shënoni në cilën formë dëshironi të kontaktoheni (postë, telefon, e-mail).	<input type="checkbox"/> Me telefon: _____ <input type="checkbox"/> Me e-mail: _____
Gjuha e preferuar për komunikim	<input type="checkbox"/> Shqip <input type="checkbox"/> Serbisht <input type="checkbox"/> Anglisht
Përshkrimi i incidentit për Ankesë	Çka ka ndodhur? Ku ka ndodhur? Çka ka ndodhur? Cila është pasoja e problemit?
Data e incidentit / Ankesës	
	<input type="checkbox"/> Incidenti/ankesa ka ndodhur vetëm një herë (data _____) <input type="checkbox"/> Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____) <input type="checkbox"/> Vazhdon të ndodh (për momentin jeni duke përjetuar problemin)

Çka do të donit të ndodh?

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Ju lutemi kthejeni këtë formular tek:

z. Lulzim rexhepaj
(Ankesat për Transport Publik)

Trafiku Urban JSC
Ruga Tahir Zajmi pn
Prishtinë, Kosovë
+377 44 135 716
Email: lulzim.rexhepaj@trafikurban-pr.com



TrafikuUrban 

The logo for TrafikuUrban, consisting of the company name in a bold, blue, sans-serif font, followed by a stylized blue and white graphic of a train or tram.